

SFIDAT E INTEGRIMIT TË REFUGJATËVE NË SHQIPËRI

Hortenc Balla

Mariana Hereni

Andi Pipero

Xymena Dyduch

Ky publikim u bë i mundur me mbështetjen financiare të Fondacioneve të Shoqërisë së Hapur, Programi Lindje-Lindje Përtej Kufijve.



Opinionet e shprehura në këtë publikim janë vetëm ato të autorëve dhe nuk reflektojnë domosdoshmërisht opinionet e Fondacioneve të Shoqërisë së Hapur.

Përmbajta është e bazuar në njohuritë dhe përvojën e UNHCR - Shqipëri dhe Shërbimet Shqiptare për Refugjatë dhe Migrantë, partner implementues i UNHCR – Shqipëri si dhe i Shoqatës për Ndërhyrje Ligjore me qendër në Varshavë, Poloni, e cila asiston refugjatët në procesin e tyre integruar ditë pas dite.

Me mbështetjen e:



Parathënie

Këto rekomandime janë përgatitur në kuadrin e projektit “Partneriteti Shqiptaro-Polak për reduktimin e përjashtimit social të refugjatëve” të Soros Shqipëri dhe Fondacionit Polak Batory, që zë fill nga eksperiencia ditore e akumuluar gjatë punës me refugjatët prej dy organizatave Shërbimet Shqiptare për Refugjatë dhe Migrantë (RMSA) dhe Ndërhjyre Ligjore në Poloni (SIP).

Qëllimi i këtij publikimi është të përmbledhë pengesat kryesore që hasin refugjatët në Shqipëri dhe të sugjerojë zgjidhje që çojnë drejt integrimit të plotë në vendin pritës.

Gjatë periudhës së zbatimit të projektit, një ekip me përbërje nga RMSA, UNHCR, Drejtoria për Shtetësinë dhe Refugjatët (DfNR) si dhe Qendra Pritëse Babrru morën pjesë në një vizitë studimore në Poloni ku patën takime me përfaqësues të qeverive vendore dhe qendrore dhe organizatave jo – qeveritare përgjegjëse për komponentë të ndryshëm të politikave të integrimit. Gjatë kësaj vizite ata krahasuan eksperiencën e tyre të përditshme me politikën vendore në Poloni, të formësuara gjerësisht nga praktikën e Bashkimit Europian. Sipas disa studimeve, Polonia ka bërë përpjekje të shumta për të përshtatur statusin e saj relativisht të ri të refugjatëve, sipas standardeve të përcaktuara nga Shtetet Antare¹. Pretendohet se Polonia ka vendosur një gur kilometrik në integrimin e fëmijëve refugjatë në shkollë².

Së fundmi, ky dokument u përgatit që të shërbejë si referencë për përmirësimin e problemeve më emergjente të komunitetit të refugjatëve në Shqipëri.

Autorët:

Mariana Hereni – Drejtore Ekzekutive, Shërbimet Shqiptare për Refugjatë dhe Migrantë
Hortenc Balla – Shef i Zyrës, UNHCR Shqipëri
Andi Piperio – Këshilltar Ligjor, Shërbimet Shqiptare për Refugjatë dhe Migrantë
Xymena Dyduch – Koordinatorë e Projektit

Reçenca dhe Konsultimet:

Aleksandra Chrzanowska – Asistent për Integrimin dhe Ndërkulturalizmin, Shoqata për Ndërhjyre Ligjore, Varshavë, Poloni
Dominik Wach – Punonjës Social, Qendra e Varshavës për Asistencë në Familje, Administrata Powiat, Varshavë, Poloni
Witold Klaus – President i Bordit të Shoqatës për Ndërhjyre Ligjore

¹ *Integrimi i Fëmijëve Refugjatë dhe Azil-kërkues në Sistemin Arsimit të Shteteve Antare të BE: Vlerësimi dhe Promovimi i Praktikave më të Mira Aktuale* të koordinuara nga Qendra për Studim të Demokracisë, Sofie, Bullgari, fq.293, e gjendur në http://www.csd.bg/fileadmin/user_upload/INTEGRACE_handbook.pdf (05.01.2013)

² Raporti i UNHCR-AGDM 2009 “Të jesh Refugjat”. Përvoja jetësore e Refugjatëve dhe Azil-kërkuesve në Europën Qendrore, fq.37

TABELA E PËRMBAJTJES

| | | |
|----------|---|-----------|
| 1 | SFIDAT NË INTEGRIMIN E REFUGJATËVE NË SHQIPËRI..... | 4 |
| 1.1 | Arsimimi..... | 4 |
| 1.2 | Kurset e gjuhës..... | 7 |
| 1.3 | Punësimi..... | 7 |
| 1.4 | Qasja në sistemin e shërbimeve sociale..... | 9 |
| 1.5 | Integrimi Lokal..... | 10 |
| 1.6 | Strehimi..... | 10 |
| 1.7 | Shëndetsia..... | 11 |
| 1.8 | Identiteti ose tipet e tjera të dokumenteve..... | 12 |
| 1.9 | Nevojat e Refugjatëve Vulnerabël..... | 12 |
| 1.10 | Natyralizimi..... | 13 |
| 2 | Rekomandimet..... | 15 |
| 2.1 | Shërbimet Shqiptare për Refugjatët dhe Migrantët (RMSA)..... | 17 |
| 2.2 | Projektet dhe aktivitetet e realizuara nga RMSA..... | 17 |
| 2.3 | Shoqata për Ndërhyrje Ligjore (Stowarzyszenie Interwencji Prawnej – SIP)..... | 18 |
| 2.4 | Projektet dhe aktivitetet e realizuara nga SIP..... | 18 |

1 SFIDAT NË INTEGRIMIN E REFUGJATËVE NË SHQIPËRI

Kurdo përmendet termi *refugjat*, ai përfshin gjithashtu edhe personat nën mbrojtje plotësuese sipas Ligjit Shqiptar për Azilin.

1.1 Arsimimi

Arsimimi është i domosdoshëm në lehtësimin e pjesmarrjes së refugjatëve në jetën ekonomike, sociale dhe kulturore të vendit pritës të refugjatëve. Në rastin e fëmijëve refugjatë dhe adoleshentëve ai përforcon konceptin e përditshmërisë dhe normalitetit në jetën e tyre si dhe është thelbësor për zhvillimin e tyre psikologjik dhe intelektual³. Sigurimi i të drejtës për arsimim dhe trainim zmadhon në mënyrë domethënëse shanset për hyrje në tregun e punës si dhe gjetjen e një vendi pune afatgjatë.

E drejta për arsim publik fillor dhe para-universitar garantohet në Nenin 22 i Konventës së Gjenevës.

Referuar Nenit 10 të Direktivës së Pritjes dhe Nenit 14 të Direktivës së Pritjes të Ndryshuar, fëmijët nuk mund të lihen jashtë shkolle për më tepër se tre muaj, kur prindrit e tyre janë regugjatë. Kjo do të thotë që gjatë kohës së shqyrtimit të aplikimit për azil, fëmija në moshë për arsim të detyruar duhet të përfshihet në sistemin para-universitar kombëtar.

Të gjithë fëmijët e refugjatëve dhe azil-kërkuesve në Shqipëri mbulohen nga sistemi shkollor dhe janë të regjistruar në shkollat respektive. Regjistrimi përfshin sigurimin e të gjithë dokumentacionit të nevojshëm që kërkohet për nxënësit shqiptarë, si certifikatat e lindjes, vërtetimin e banimit, etj. Refugjatët që largohen nga vendet e tyre nga frika e rezikut të persekutimit shpesh nuk mbartin dokumente me vete. Mungesa e dokumentave është pengesa e parë me të cilën fëmijët refugjatë përballen në momentin e regjistrimit. Thjeshtëzimi i procedurave sa i përket shmangjes së pengesave me dokumentacionin është i nevojshëm dhe është aplikuar në Ligjin për Integrimin në rastin e procedurave të bashkimit familjar. Lehtësirat në paraqitjen e dokumentave në kohën e regjistrimit në

³ Axxhenda e UNHCR për integrimin e Refugjatëve në Europën Qëndrore, Përfaqësia Rajonale e UNHCR për Europën Qëndrore, Budapest, Prill 2009

shkollë janë aplikuar në Poloni, ku të gjithë fëmijët e refugjatëve dhe azil-kërkuesve janë pranuar në shkolla edhe nëse ata nuk kanë poseduar asnjë lloj dokumenti.

Faktikisht, regjistrimi rast pas rasti varet nga dëshira e mirë e drejtorëve të shkollave, për shkak të mungesës së udhëzimeve dhe akteve nën-ligjore që do t'ua bënin të detyrueshëm drejtorive të shkollave pranimin e fëmijëve refugjatë apo azil-kërkues që jetojnë në zonën në të cilën ka juridiksion shkolla. Ka një nevojë urgjente për një udhëzim apo akt nënligjor të përshtatshëm për të përcaktuar dhe qartësuar detyrimin e drejtorive të shkollave për të pranuar dhe regjistruar fëmijët refugjatë në zonat të cilat ato mbulojnë. Në Poloni, e drejta (dhe detyrimi) për shkollim dhe edukim për emigrantët minorenë të larguar me forcë garantohet nga Akti për Sistemin Arsimor si dhe rregulloret respektive të Ministrisë së Arsimit. Këto akte ligjore zgjidhin problemet e qasjes në sistemin shkollor.

Vlerësimi i nivelit të njohurive të fëmijëve refugjatë dhe azil-kërkues në Shqipëri bëhet nëpërmjet komisioneve *ad hoc* të ngritura nga Drejtoria Arsimore në shkollat ku fëmijët refugjatë dhe azil-kërkues janë pranuar.

Materialet shkollore dhe uniformat. Shteti ofron librat shkollorë (me çmim të reduktuar njëlloj si për fëmijët shqiptarë) por mbeten gjithsesi nevoja të mëdha për materiale shkollore dhe uniforma, teksa fëmijët refugjatë hyjnë në grupin social më pak të privilegjuar kur diskutohet për arsimimin.

Fëmijët e refugjatë dhe azil-kërkues nga mosha 14 deri në 25 kanë nevojë për mbështetje dhe mjete të veçanta. Shpesh, teksa i afrohen fundit të karrierës së tyre shkollore, ata nuk bartin kualifikime akademike. Ndonjëherë atyre u është refuzuar rregjistrimi në shkolla të mesme të përgjithshme duke i shtyrë të rregjistrohen në kurse profesionale të cilat nuk kanë qenë gjithmonë të përshtatshme apo të dëshiruara. Ca më keq, shpesh ata detyrohen të qëndrojnë në shtëpi, pasi e kanë kaluar moshën e arsimit të detyruar (mbi 16 vjeç), por janë tepër të rinj për tu konsideruar si forcë pune (mbi 18 vjeç). Ky grup ka kapacitetin dhe potencialin për të arritur nivele të larta motivimi. Megjithatë, nëse neglizhohet, nivelet e motivimit mund të bien në ekstremitete të

rezikshme⁴. Sipas Nenit 14 të Direktivës së Pritjes arsimit të mesëm nuk duhet të bëhet i pamundur vetëm me arsyetimin se minoren ka arritur moshën e pjekurisë. Konventa e Gjenevës në Nenin 22.1 rekomandon Shteteve Anëtare që t'u japin refugjatëve një trajtim sa më të favorshëm për sa i përket arsimimit përtej shkollës fillore.

Ekziston një kontraditë në Ligjin Shqiptar mbi moshën për arsim të detyruar. Nga njëra anë, arsimi i detyruar shtrihet deri në moshën 18 vjeçare, dhe nga ana tjetër shkollave u jepet e drejta për të përjashtuar një minoren përtej moshës 16 vjeçare në momentin që ai/ajo bëhet pengesë për vazhdimësinë normale të procesit mësimor. Sfidat e parë është pranimi, në këto institucione të arsimit të përgjithshëm, i refugjatëve që kanë kaluar moshën 16 vjeçare dhe së dyti sigurimi i kuadrit ligjor për shkollat me kohë të pjeshme, në mënyrë që ata që dëshirojnë këtë lloj forme shkollimi të marrin arsimimin e nevojshëm sipas preferencës.

Arsimi Para-shkollor. Vihet re një mungesë dëshire për të pranuar fëmijët refugjatë në kopshte publike. Praktika në vendet e Bashkimit Europian ka provuar se lehtësimi i krijuar nga pranimi i fëmijëve në çerdhe shkarkon nënat nga një pjesë e detyrimeve të tyre, si për shembull kujdesi për të vegjlit e tyre, gjë që u jep atyre mjaftueshëm kohë të lirë për ndjekur kurse profesionale, gjuhësore, apo angazhim në punë⁵.

Arsimi i Lartë. Refugjatët që arrijnë në Shqipëri dhe duan të konkurojnë për një të drejtë studimi të shkollës së lartë, nuk kanë asnjë lehtësim krahasuar me vendasit. Ata duhet të paraqesin dokumentacion të plotë të rezultateve të tyre të mëparëshme arsimore. Sërish mungësa e dokumentacionit përkthehet në një pengesë të jashtëzakonshme. Ekziston nevoja për skema vlerësimi fleksible për këtë kategori personash, ashtu si edhe për fëmijët e shkollave para-universitare.

Për më tepër refugjatëve që kërkojnë të konkurojnë për një të drejtë studimi universitare në Shqipëri u kërkohet të provojnë nëpërmjet një provimi njohuri të mjaftueshme të gjuhës shqipe ashtu si edhe vendasve. Ndoshta kjo nuk është problematike për shqiptarët e

⁴ ECRE Udhëzues i Praktikave të Mira për Arsimin, fq. 22

⁵ ECRE Udhëzues i Praktikave të Mira për Arsimin, fq. 40

Kosovës, por ajo është një pengesë serioze për hyrje në universitet për refugjatët e tjerë. Refugjatët, si të huaj që janë, nuk duhet t'u kërkohet të kenë njohuri të gjuhës shqipe në nivele të gjuhës amtare, por aq sa çdo i huaj tjetër që dëshiron të studiojë në Shqipëri, në përputhje me Nenin 22.1 të Konventës së Gjenevës.



Shkollë verore. Burimi: UNHCR

Boshllëqet:

- Mungesa e vendimeve të qeverisë dhe akteve nën-ligjore që u imponon shkollave rregjistrim të detyrueshëm për fëmijët refugjatë dhe azil kërkues që jetojnë në zonë;
- Thjeshtësim i kërkesave për dokumentacionin që duhet paraqitur nga kandidatët refugjatë dhe azil-kërkues në shkolla;
- Ulje e pamjaftueshme e kostove të materialeve shkollore dhe librave për refugjatët dhe azil-kërkuesit si grup social më pak i privilegjuar;
- Legjislacion i paplotë adresuar refugjatëve dhe azil-kërkuesve të moshës 16-18 vjeç që nuk u jep mundësinë për të hyrë në shkollat e përgjithshme;

- Mungesë e mundësisë për të hyrë në shkolla me kohë të pjesshme për personat mbi 18 vjeç me boshllëqe në arsimim;
- Mungesë e kurseve profesionale pa pagesë për refugjatët e interesuar mbi 16 vjeç;
- Mungesë e mbështetjes akademike (si për shembull, klasë shtesë në gjuhën shqipe, klasë për personat me nevoja të veçanta që synojnë mbushjen e boshllëqeve në arsimim)⁶.

Parashkollori:

- Mungesa e një rregulloreje të qartë që përfshin fëmijët refugjatë në grupin prioritar të pranuar në çerdhet publike;

Arsimimi Tretësor:

- Mungojnë tarifata e reduktuara ose favorizuese për hyrjen në universitet për fëmijët refugjatë;
- Mungojnë skemat fleksible të vlerësimit për rastet në të cilat mungon dokumentacioni;
- Kompetencë e njohjes së gjuhës shqipe në nivelin e njohjes nga të huajt.

1.2 Kurset e Gjuhës

Mësimi i gjuhës të vendit pritës është një kusht i domosdoshëm për integrimin e mëtejshëm, pavarësisht nëse personit i njihet apo i refuzohet statusi i refugjatit, dhe pavarësisht qëndrimit afatshkurtër apo afatgjatë në tij/saj në vendin pritës. Mësimi duhet të fillojë që në fillim, fill pas mbërritjes në vendin pritës, falas në qendrën e pritjes, gjë që do të mundësojë një shkallë më të lartë pjesëmarrjeje, veçanërisht për nënat me fëmijë të vegjël ose mosha e tretë (grupet vulnerable).

Përveç kurseve të gjuhës, refugjatëve duhet tu ofrohet orientim dhe drejtim që përmban informacione praktike në lidhje me vendin e azilit, institucionet e tij, shërbimet e ofruara dhe pikat e referencës. Praktika e Zyrës për të Huajt në Ministrinë e Brendshme Polake tregon se ky lloj informacioni mund të ofrohet në formën e një sesioni pas komunikimit

⁶ Shih op.cit.1

paraparak në qendrën e pritjes apo edhe në formën e libërthit ose direktivave të përkthyer në gjuhën e origjinës⁷.

Në Shqipëri nuk ekzistojnë kurset e gjuhës pa pagesë për refugjatët dhe azil-kërkuesit. Qeverisë i mungojnë stukturat institucionale për ofrimin e gjuhës shqipe. Kurset ekzistuese *ad hoc* (gjithnjë me pagesë, të ofruara nga Fakulteti i Gjuhëve të Huaja) nuk u adresohen grupeve të caktuara por janë të përgjithshme. Për më tepër, ato u adresohen më së shumti atyre që synojnë të konkurojnë për një të drejtë studimi në sistemin universitar⁸. Ekziston nevoja për mësimdhënie të institucionalizuar të gjuhës shqipe për azil-kërkuesit sapo ata të ndër marrin procedurën e Përcaktimit të Statusit të Refugjatit.

Boshllëqet:

- Mungesa e kurseve të gjuhës pa pagesë të ofruara në Qendrat e Pritjes nëpërmjet institucioneve Shtetërore apo nëpërmjet fondeve për OJF-të;
- Mungesa e fushatave pa pagesë për rritjen e ndërgjegjësimit, që mbulojnë informacione praktike në lidhje me Shqipërinë pas mbërritjes në Qendrat e Pritjes, ku si alternativë do të ishte shpërndarja e libërthave të informimit në gjuhën e origjinës të refugjatëve.

⁷ Vizitë studimore e RMSA dhe UNHCR në zyrën për të Huajt, Ministria e Brendshme Polake, Varshavë, Poloni në 03.10.2012

⁸ Probleme / Risqet e Personave me të cilët kemi të bëjmë, UNHCR Shqipëri, Letër e brendshme.



Burimi: RMSA

1.3 Punësimi

Direktiva e Cilësisë së Punësimit të BE-së u garanton refugjatëve trajtim të barabartë në punësim, duke u siguruar që Shtetet Anëtare të luftojnë çdo lloj diskriminimi në punë mbi bazat e përkatësisë fetare apo besimit, aftësisë për punë, moshës apo orientimit seksual përsa i përket punësimit dhe profesionit⁹.

Refugjatët të cilët e kanë fituar statusin e refugjatit në Shqipëri kanë të drejtë të punojnë në kushte të barabarta me vendasit. Kjo e drejtë që njihet në Ligjin për Integrimin dhe buron nga Neni 24 i Konventës së Gjenevës, gëzohet pa limite kohore, por ama limitohet nga praktika e ligjit në Shqipëri. Referuar Ligjit për Integrimin, një refugjat të cilit i është njohur statusi, duhet që të pajiset me leje pune për një periudhë 5 vjeçare, megjithatë deri tani, lejet e dhëna të punës kanë qenë 1 vjeçare, të rinovueshme 2 herë, deri në lëshimin e lejes

⁹ Neni 1i Direktivës për Barazi Punësimi

5 vjeçare. Koha e pritjes për dhënien e lejes së punës është shumë e gjatë, dhe shpesh mungesa e dokumentacionit pengon punësimin, edhe aty ku refugjatit i lejohet të punojë. Pengesat administrative nuk duhet të kthehen në shqetësim për hyrjen në tregun e punës për kategori personash, teksa në përgjithësi hyrja e të huajve në tregun e punës është sfidë në vetvete.

Nga ana tjetër, ekziston një nivel i lartë mosbesimi që vjen nga mungesa e njohurive nga ana e punëdhënësve, të cilët shpesh i trajtojnë refugjatët si të huajt e tjerë të ligjshëm, apo më keq, të paligjshëm, dhe ngurrojnë që t'i punësojnë ata. Edhe vetë administrata shtetërore punëson vetëm qytetarë shqiptarë.

Sa për azil-kërkuesit Direktiva Europiane lejon dhënien e lejeve të punës nëse koha e pritjes deri në dhënien e vendimit të njohjes i kalon të 6 muajt. (Propozimi i Amenduar për Direktivën e Parlamentit Europian dhe Komisionit Europian i cili parashtron standardet për pritjen e azil-kërkuesve) 01.06.2011 COM2011 320 final, 2008/2044 COD.

Boshllëqet:

- Ndarja aktuale e dokumentacionit në leje qëndrimi dhe pune shkakton vonesa dhe probleme në rrugën e integritit të refugjatëve. Praktika në Poloni tregon se është me efikase nëse leja e qëndrimit për refugjatët që e kanë fituar statusin të njihet njëkohësisht edhe si leje pune;
- Periudha e vlefshmërisë për lejet e qëndrimit dhe lejet e punës parashikohet në Ligjin aktual për Të Huajt nr. 9959. Ekziston nevoja për të përshtatur këtë ligj me afatet kohore të lejeve të punës të përcaktuara në Nenin 13 të Ligjit për Integrimin, meqë ky i fundit prevalon në këtë rast me statusin e *lex specialis*.
- Direktivat e BE japin për azil-kërkuesit mundësi për të punuar pasi të kenë mbushur gjashtë muaj qëndrim në vendin pritës. Kjo nuk është e mundur në Shqipëri për shkak të dispozitave në Ligjin në fuqi Për Refugjatët nr. 9959.
- Përfshirja e refugjatëve që u është njohur statusi në sistemin elektronik të kartave të identitetit ka qenë një proces i ngadaltë dhe ka paraqitur dy mangësi kryesore:

- Refugjatët që sapo u është njohur statusi nuk regjistrohen automatikisht në sistem, dhe procesi varet nga koordinimi i Drejtorisë për Shtetësinë dhe Refugjatët dhe aktorëve të tjerë të përfshirë;
- Personave që u është njohur statusi dhe ekzistojnë në sistem, nuk kanë mundësi të pajisen me çertifikata të lindjes apo familjare, të dalin po nga sistemi. Kjo e bën të gjithë procesin të pakuptimtë dhe e kthen atë më tepër në një mjet kontrolli për policinë se sa një regjistër që mundëson integrimin.



Biznes i suksesshëm në Tiranë. Burimi:RMSA

1.4 Qasja në sistemin e shërbimeve sociale

Në përputhje me ligjin në fuqi dhe amendimeve të propozuara ndaj tij, refugjatët do të gëzojnë, në përputhje me ligjin shqiptar, të njëjtin trajtim social si dhe shtetasit shqiptarë (Neni 15 i Ligjit për Integrimin) ose do të jenë subjekte të Ligjit nr. 7710, datë 18.05.1993 “Për Asistencën dhe Ndhimën Sociale”. (Drafti i amendimeve për Ligjin për Integrimin).

Në përputhje me Nenin 17 të Ligjit për Integrimin parashikohet një lloj asistence e veçantë për familjet e refugjatëve të cilat nuk kanë asnjë të ardhur apo asnjë mjet jetese në përgjithësi, apo nuk kanë të ardhura të mjaftueshme dhe mjete jetese në dispozicion.

Procedurat dhe kriteret për vlerësimin e nivelit të ndihmës ekonomike, mungesa e të ardhurave dhe burimeve materiale për të dhënë ndihmë sociale, si dhe pagesa minimale e ndihmës sociale do të përcaktohen nga një Akt i përbashkët i Ministrisë të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta dhe Ministrive të linjës prej së cilës varet edhe Drejtoria për Shtetësinë dhe Refugjatët.

Megjithëse ekzistojnë mekanizma apo dihet se cilët mekanizma duhen vënë në lëvizje, nuk ka asnjë lloj asistence sociale për familjet refugjate që jetojnë jashtë Qendrave të Pritjes. Kjo situatë kërkon ndërhyrje urgjente dhe thirrje për nxjerrjen e akteve të nevojshme ligjore sepse Shqipëria ka detyrime në zbatim të Konventës së Gjenevës, e cila në Nenin 23 parashikon se refugjatët duhet të marrin të njëjtin trajtim si dhe shtetasit shqiptarë përsa i përket asistencës sociale dhe ndihmës ekonomike.

Pensioni i pleqërisë varet drejt për drejt nga marrëveshjet përkatëse dypalëshe midis Shqipërisë dhe vendit të origjinës të refugjatit. Kjo zgjidhje nuk është e mjaftueshme, pasi shpesh nuk ka fare marrëveshje bilaterale ose vendi i origjinës të refugjatit refuzon të bashkëpunojë në zgjidhjen e të drejtës së pensionit për refugjatin.

Boshllëqet:

- Nuk ka asnjë akt të përbashkët të Ministrisë të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta dhe Ministrisë të Brendshëm për zbatimin e dispozitave për asistencën sociale për refugjatët;
- Mungojnë fondet e mjaftueshme për të mbuluar nevojat e refugjatëve;
- Mungon asistenca financiare periodike për personat të cilët kanë arritur moshën e pensionit të pleqërisë kur nuk ka mënyra të tjera për të përcaktuar masën e pensionit.

1.5 Integrimi lokal

Praktika në vendet e BE dëshmon se ndihma sociale nuk është e mjaftueshme për refugjatët për t'u integruar. Sa më shumë mbështetje për integrim në formën e këshillimit, udhëzimeve dhe fondeve ata të marrin, aq më mirë mund të integrohen. Eksperienca që buron nga shembulli Polak, në të cilën janë paraqitur të ashtuquajturat paketa integruese, tregon që programi drejtues 1 vjeçar është shumë i shkurtër si kohë për integrim. Sa më e gjatë të jetë koha e përshtatshme e integritit, aq më të mëdha janë rezultatet e integritit. Integrimi nuk do të thotë domosdoshmërisht ndihmë financiare. Këshillimi duhet të përfshijë dhënien e këshillimit të karrierës, trajnim për aftësitë e kërkimit të punës, këshillim në lidhje me vendet e lira të punës, negocim me punëdhënësit dhe në përgjithësi ndryshimin e qëndrimit të të gjithë aktorëve të përfshirë.

Ka përjasje të ndryshme për integrimin. Vendet Skandinave e kanë institucionalizuar sistemin e integritit ndërsa vendet e tjera të BE u'a kanë dhënë këtë atribut OJF-ve¹⁰. Nëse integrimi lihet në dorë të OJF-ve, ato konkurojnë për fondet në dispozicion nga qeveria qendrore dhe vendore për të realizuar aktivitetet për refugjatët. Ato vlerësohen regullisht, gjë që përmirëson transparencën në menaxhimin e fondeve.

Boshllëqet:

- Mungesa e programeve të veçanta të integritit që përfshin asistencën ekonomike, këshillimin dhe mbështetjen gjuhësore të drejtuar ose nga institucionet publike ose nga OJF-të;
- Pamjaftueshmëri urash lidhëse ndërmjet punë-dhënësve, pronarëve, administratës vendore dhe refugjatëve (fushatë informimi për punë-dhënësit dhe administratën për vendosjen e shpalljeve të vendeve të lira të punës direkt në ambientet e Qendrës Pritëse).

¹⁰ ECRE Udhëzues i Praktikave të Mira për Arsimin, fq. 9



Festa e Vitit të Ri. Burimi:RMSA

1.5 Strehimi

Komiteti European për të Drejtat Sociale ka deklaruar se të drejtat sociale të lidhura me dinjitetin duhet të garantohen për çdokënd (shtrirë qasja edhe ndaj refugjatëve dhe azil-kërkuesve nëpërmjet Apendiksit, edhe nëse kërkesat e tyre refuzohen), ku një prej këtyre të drejtave themelore sociale është e drejta për shtehim¹¹.

Konventa e Gjenevës parashikon që Shtetet Palë duhet t'u akordojnë refugjatëve që qëndrojnë ligjërisht në shtetet e tyre, banesa me kushte sa më të favorshme të jetë e mundur, dhe në çdo rast, jo më pak të favorshme së të huajt e tjerë që gjenden në të njejtën situatë. (Neni 21 i Konventës së Gjenevës).

Ligji për Integrimin siguron mjetet e nevojshme për politika efektive strehimi. Ai parasheh si vijon:

¹¹ Jean-Michel Belorgey, Raportues i Përgjithshëm, Komiteti European për të Drejtat Sociale, diskutimet Finale, Tavolina e Rumbullakët mbi të Drejtat Sociale të Refugjatëve, Azil-Kërkuesve dhe Personat e Zhvendosur brenda Vëndit: Perspektivë Krahasuese, 7 Dhjetor 2009, Strasburg

1. Të drejtën për tu vendosur në institucione publike të asistencës sociale kur përmbushen kriteret;
2. Të drejtën e përfitimit të strehimit;
3. Të drejtën për të qëndruar në qendrën e pritjes për ata që nuk i'a dalin të sigurojnë strehim për veten e tyre;
4. Asistencë për strehimin nëpërmjet pagesës së gjysmës së qirasë.

Të gjitha këto mënyra mbështetje mund të lehtësonin tranzicionin nga Qendrat e Pritjes në “tregun e lirë” të strehimit nëse do të ekzistonin mjetet për implementim.

Në Poloni, të huajt të cilët kanë përfituar statusin e refugjatit ose marrin mbrojtje ndihmëse, ose kanë të njëjtat të drejta për strehim ashtu si edhe qytetarët polakë. Ata mund të aplikojnë për shtëpi/apartamente sociale në zonën ku jetojnë. Personat vulnerabël, përfshi edhe refugjatët, mund të aplikojnë për të ashtu-quajturat apartamente të mbrojtura ku krahas të tjerave mund të asistohen edhe nga punonjës socialë, psikologë dhe specialistë. Më së shumti, kjo lloj mbështetje për strehim jepet për një periudhë të caktuar kohore, por në raste të justifikuar apartamentet e mbrojtura mund të jepen edhe përgjithmonë¹². Zgjidhje tjetër me masa të përkohshme, që do t'i ndihmonte refugjatët që të pavarësoheshin nga sistemi mbështetës që ata kanë në Qendrën e Pritjes, është mbështetja tek organet vendore për të manaxhuar të “ashtu-quajturat” apartamente të mbrojtura. Praktika e ndjekur në Poloni¹³ ka qenë e suksesshme. Familjet dhe individët më vulnerabël mund të aplikojnë për të qëndruar më tej në një apartament të mbrojtur të dhënë nga Këshilli Bashkiak, aty ku qiraja garantohej nga programi. Përfituesit mund të qëndrojnë për një vit, me mundësi shtyrje edhe për një vit tjetër. Programi i ndihmon refugjatët për t'u qetësuar dhe për t'u përqëndruar në kërkimin e një vendi pune.

Boshllëqet:

- Mungesa e akteve nën-ligjore të përshtatshme për zbatimin e politikave të strehimit të parashikuara nga Ligji për Integrimin;
- Mungesa e një projekti pilot në Tiranë me 1 apartament të mbrojtur për familjen refugjate më vulnerable nga Këshilli Bashkiak i Tiranës;

¹² Kjo rregullohet nga Ministria e Punës dhe e Politikave Sociale.

¹³ Janë rregulluar veçanërisht për refugjatët 3 apartamente të cilët jepen për periudha 6 deri në 24 muaj me të drejtë shtyrje deri në 3 muaj të tjerë në raste të justifikuar, si dhe në Varshavë 1 apartament është krijuar veçanërisht për refugjatët që jepen për 6 muaj me mundësinë për tu shtyrë edhe për 3 muaj të tjerë.

Vizita studimore e RMSA, UNHCR në Varshavë dhe në Qendrën për Mbështetje të Familjes, Lublin, Poloni në 03.10.2012

- Mungesa e fondeve të nevojshme për sigurimin gradual të politikave të strehimit.

1.7 Shëndetsia

Deri tani, të gjithë refugjatët janë paisur me libreza shëndetsore ndërsa është ofruar shërbimi parësor shëndetsor i mbuluar nga qeveria. Përfshirja në listën e përfituesve varet nga korrespondenca periodike që i dërgohet Institutit të Sigurimeve Shëndetsore nga Drejtoria për Shtetësinë dhe Refugjatët. Nuk ka nevojë për lista shtesë të refugjatëve me të drejtë përkujdesi shëndetsor për shkak se Vendimi respektiv i Këshillit të Ministrave u jep të drejtë të gjithë personave me leje qëndrimi mundësi për të përfituar nga sistemi shëndetsor. Sfida e qeverisë është të aplikojë në mënyrë efektive Ligjin për Integrimin për të siguruar mbulim të plotë dhe të qëndrueshmën të kujdesit shëndetsor për personat e interesuar.

Shumica e pjestarëve të stafit të qendrave shëndetsore nuk kanë dhënë shërbime mjeksore për refugjatët apo nuk janë përkujdesur për ta pasi nuk kanë qenë në dijeni nëse këto shërbime mbuloheshin nga ndihma mjeksore falas e Ministrisë së Shëndetsisë.

Boshllëqet:

- Mungesa e ngritjes së vetë-dijes të stafëve të qendrave shëndetsore në të gjithë vendin, duke u përqëndruar aty ku prania e refugjatëve është më e lartë, për të drejtat shëndetsore të refugjatëve dhe azil-kërkuesve;
- Informacion dhe mbështetje e pamjaftueshme gjatë procedurës së regjistrimit për librezë shëndetsore në Institutin e Sigurimeve Shëndetsore apo nivele të tjera të organeve përkatëse.

1.8 Dokumentat e Identitetit ose tipet e tjera të dokumenteve

Dokumentacioni për azil-kërkuesit duhet të sigurohet brenda 3 ditëve në bazë të Nenit 6 të Direktivës së Pritjes.

I vetmi dokument që refugjatët apo azil-kërkuesit (dokument që lëshohet të paktën 90 ditë pas mbërritjes) kanë është leja e qëndrimit, një fletë format A4 që mban vulën e Policisë Kufitare si dhe foton e bartësit, por që nuk ka asnjë kod (numër serial) apo element sigurie,

kësisoj duke u bërë i papranueshëm p.sh në banka. Dokumenti ndihmon vetëm për identifikimin e personave ndaj policisë (mbrojtje ndaj *non refoulment*) dhe për të mbështetur kërkesat për sigurim dhe mbulim shëndetsor.

Kjo situatë krijon dizavantazhe serioze për refugjatët.

Dokumentet elektronike të Identifikimit ID të cilat do t'u jepen shqiptarëve madhorë duhet të përfshijë edhe refugjatët në sistem.

Aktualisht, pasi dikujt i konfirmohet statusi i refugjatit, ai/ajo duhet të presë deri në 45 ditë për të marrë dokumentin përfundimtar të identifikimit ID.

Boshllëqet:

- Përfshirje jo e plotë e refugjatëve në sistemin elektronik të identifikimit ID;
- Pritje e gjatë për lëshimin e dokumentit.

1.9 Nevojat e refugjatëve vulnerabël

Nevojat e refugjatëve vulnerabël nuk mbulohen nga Ligji për Integrimin po ashtu siç nevojat e azil-kërkuesve në Proçedurën Vendimarrëse për Statusin e Refugjatit nuk mbulohen nga Ligji për Azilin. Siç theksohet në Direktivën e Pritjes, rastet vilnerabël meritojnë trajtim të veçantë. Sipas Direktivës së Pritjes refugjatë dhe azil-kërkues vulnerabël quhen personat e këtyre grupeve që janë: me aftësi të kufizuara, të moshuar, prindër të vetëm, gra shtatzëna, minorenë, viktima të trafikimit apo paaftët mendorë.

Direktiva e Pritjes vë në dukje nevojën për identifikim të hershëm të nevojave të personave vulnerabël për të përgatitur proçedurat e trajtimit të veçantë për to kur janë në proçes të përcaktimit të statusit të refugjatit, gjë që kërkon zyrtarë të përgatitur dhe trainuar posaçërisht për zhvillimin e seancave dëgjimore për Proçedurën e Përcaktimit të Statusit të Refugjatit.

Deri tani, është e pamundur për refugjatët që të pranohen në proçedurën e njohjes së paaftësisë për punë, gjë që i privon ata nga asistenca sociale e parashikuar për këtë kategori personash.

Prindrit e vetëm të papunë apo gratë shtatzëna nuk kanë të drejtë për ndihmë sociale nëse janë të papunë dhe vendosin të jetojnë jashtë Qendrës së Pritjes.

Ata duhet të përfshihen në sistemin e ndihmës sociale.

Të moshuarit të cilët nuk mund të mbështeten në konventat dypalëshe që lidhen me njohjen e ndërsjelltë të pensioneve duhet të marrin ndihma financiare nëse nuk kanë të ardhura personale apo ligjore.

Boshllëqet:

- Mungesa e zbulimit të hershëm të nevojave të personave vulnerabël të cilët janë në Proçedurën e Përcaktimit të Statusit të Refugjatit;
- Mungesa e trainimeve të posaçme për zbulimin e nevojave të personave vulnerabël për punonjësit e Drejtorisë për Shtetësinë dhe Refugjatët;
- Nuk ka prezencë të psikologëve gjatë seancave dëgjimore të rasteve vulnerabël;
- Mungesa e përfshirjes së refugjatëve në proçedurën e njohjes së statusit të personit me aftësi të kufizuara;
- Mungesa e asistencës sociale ekonomike për personat e moshuar pa pension, për prindrit e vetëm të papunë dhe për gratë shtatzëna.



Çift refugjatësh. Burimi:RMSA

1.10 Natyralizimi

Realizimi i plotë i të drejtave të dikujt bëhet i mundur vetëm kur ai/ajo është shtetas. Kjo forcon lidhjet që personi ka me shtetin dhe ndërton identitetin e ri në shoqërinë pritëse. Neni 34 i Konventës së Gjenevës vë në dukje se Shtetet Palë duhet të lehtësojnë procedurat e asimilimit dhe natyralizimit të refugjatëve.

Ndërkohë, natyralizimi nuk është bërë i mundur për asnjë refugjat në Shqipëri. Të gjitha përpjekjet për natyralizim në të gjithë rastet kur kjo praktikë është provuar kanë dështuar, për shkak se Qeveria ka hezitur të pranojë aplikimet e tyre për natyralizim. Ligji nuk përmban asnjë lloj përjashtimi për refugjatët. Ka ende kërkesa për dokumenta nga vendi i origjinës, si çertifikata lindje etj, megjithëse ata janë refugjatë. Një pengesë e rëndësishme është edhe kushti i cili i detyron aplikantët për të patur në një llogari bankare një shumë prej reth 3000 euro, si dhe vetë vështirësitë e hapjes së llogarisë bankare siç u përmend.

Për më tepër, procedurat janë të komplikuar për t'u ndjekur nga vetë refugjatët, kështu që nevojitet asistencë ligjore.

Boshllëqet:

- Nuk ka lehtësim të procedurave të natyralizimit për refugjatët, veçanërisht në pranimin e burimeve shtesë të provës (si për shembull pranimi i dëshmive në vend të dokumenteve);
- Ekzistenca e kushteve të paarrtshme për sigurimin e dokumenteve mbështetëse për refugjatët që kërkojnë natyralizim.

Referuar Qëndrimit 9098 për Refugjatët në Europë nga 2002¹⁴ “...kur të llogariten kostot e programeve të integritit të refugjatëve, qeveritë Europiane duhet të marrin në konsideratë kostot afat-gjata ekonomike dhe sociale që lidhen me risqet e marginalizimit të refugjatëve në rast të mos-ndërrhyrjes publike që në në fazat e para. Duke patur parasysh dimensionin European të integritit të refugjatëve dhe në bazë të solidaritetit përmes Europës, fonde të veçanta dhe të strukturuar duhet të vijojnë të jenë në dispozicion për të realizuar synimet pan-BE për integritin e refugjatëve dhe për të promovuar harmoninë sociale”.

2 REKOMANDIME

- Nxjerrja e një akti nën-ligjor mbi regjistrimin e detyrueshëm në shkolla të fëmijëve refugjatë dhe azil-kërkues që jetojnë në zonën e juridiksionit të shkollës; dhe për lehtësimin e kërkesave për dokumentacionin që duhet të paraqesin kandidatët refugjatë apo azil-kërkues, për të drejta studimi;
- Heqje e plotë e tarifës që duhet paguar për materialet shkollore dhe librat për refugjatët dhe azil-kërkuesit;
- Legjislacion i qartë që u lejon refugjatëve dhe azil-kërkuesve të moshës 16-18 vjeç të kenë mundësi hyrje në shkollat e përgjithshme;
- Përfshirja e fëmijëve refugjatë në grupet prioritare për tu pranuar në çerdhet publike;

¹⁴ ECRE Qëndrimi 9098 për Refugjatët në Europë nga 2002, fq.26, www.ecre.org

- Zvogëlim ose heqje e tarifave administrative për regjistrim në universitet dhe skema fleksible të vlerësimit për rastet që ka mangësi dokumentacioni;
- Ndryshime ndaj Ligjit për Arsimin – përfshirje e kompetencës gjuhësore të shqipes në nivelin e folësve të huaj;
- Kurse pa pagesë në Qendrën e Pritjes ose nga institucionet Shtetërore ose nëpërmjet OJF-ve;
- Fushata ndërgjegjësuere falas që mbulojnë informacione praktike mbi Shqipërinë pas mbërritjes në Qendrën e Pritjes, ose shpërndarja e broshurave informuese në gjuhën e origjinës të refugjatit;
- Heqja e lejeve të ndara të qëndrimit dhe të punës për refugjatët nëpërmjet prodhimit të një dokumenti të unifikuar që përfshin të drejtën për të qëndruar në vend si dhe të drejtën e punës. Praktika e ndjekur në Poloni ka treguar se është më efiçase paisja e refugjatëve të cilëve u është njohur statusi me një dokument leje qëndrimi që përfshin njokohësisht të drejtën për të punuar;
- Lejet e qëndrimit duhet të përfshijnë edhe të drejtën e punës;
- Ndryshime në Ligjin për të Huajt Nr.9959 duke e përshtatur atë me periudhat e lejes së punës sipas Nenit 13 të Ligjit për Integrimin;
- Ndryshime në Ligjin për të Huajt Nr.9959 për të siguruar hyrje të tregun e punës nga azil-kërkuesit pas 6 muajsh në procedim duke i paisur me lejet respektive të punës pas një periudhe pritje relativisht të shkurtër;
- Përfshirja e refugjatëve që u është njohur statusi në sistemin elektronik të kartave të indentitetit ID;
- Firmosja e një akti të përbashkët të Ministrisë të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta dhe Ministrisë të Brendshëm me qëllim zbatimin e dispozitave të asistencës sociale për refugjatët;
- Sigurim i fondeve të mjaftueshme për të mbuluar nevojat sociale të refugjatëve;
- Ndryshime në Ligjin për Asistencë dhe Përkujdesje Sociale dhe orfim i ndihmës ekonomike sociale për refugjatët e moshës së tretë të cilët kanë arritur moshën për pension pleqërie, nëse nuk ka mundësi të tjera për të përcaktuar masën e pensionit të pleqërisë;

- Modifikim i Ligjit për Asistencë dhe Përkujdesje Sociale përmes prezantimit të programeve të veçanta të integritit duke përfshirë asistencën ekonomike, këshillimin, dhe mbështetjen gjuhësore të drejtuar ose nga institucione publike ose nga OJF;
- Ndërtimi i urave lidhëse ndërmjet punë-dhënësve, pronarëve, administratës vendore dhe refugjatëve (fushatë informimi për punë-dhënësit dhe administratën për vendosjen e shpalljeve të vendeve të lira të punës direkt në ambientet e Qendrës Pritëse);
- Nxjerrja e akteve nën-ligjore të përshtatshme për zbatimin e politikave të strehimit të parashikuara nga Ligji për Integrimin;
- Lançimi një projekti pilot në Tiranë me 1 apartament të mbrojtur për familjen refugjate më vulnerable nga Këshilli Bashkiak i Tiranës;
- Garantimi i fondeve të nevojshme për sigurimin gradual të politikave të strehimit;
- Sigurimi i shërbimit mjekësor për të gjithë personat e paisur me leje qëndrimi si refugjatë;
- Rritja e vetë-dijes të stafëve të qendrave shëndetsore në të gjithë vendin, duke u përqëndruar aty ku prania e refugjatëve është më e lartë, për të drejtat shëndetsore të refugjatëve dhe azil-kërkuesve;
- Thjeshtëzim i procedurës së regjistrimit për librezat shëndetsore në Institutin e Sigurimeve Shëndetsore apo nivele të tjera të organeve përkatëse.
- Paisje e refugjatëve me karta identifikimit ID (biometrike), si dokument për tu paraqitur gjatë kërkesës për kujdes mjekësor;
- Përfshirje e refugjatëve që u është njohur statusi në sistemin elektronik të identifikimit ID;
- Kohë me e shkurtër pritje për lëshimin e dokumentacionit, maksimumi 2 javë;
- Zbulim i hershëm i nevojave të personave vulnerabël të cilët janë në Proçedurën e Përcaktimit të Statusit të Refugjatit;
- Trainimeve të posaçme për zbulimin e nevojave të personave vulnerabël për punonjësit e Drejtorisë për Shtetësinë dhe Refugjatët;

- Përfshirje e prezencës së psikologëve gjatë seancave dëgjimore të rasteve vulnerabël;
- Përfshirje e refugjatëve në procedurën e njohjes së statusit të personit me aftësi të kufizuara me amendimet e nevojshme në Ligjin për Asistencën dhe Kujdesin Shëndetsor;

Këto rekomandime janë bazuar në shqyrtimin e:

1. Konventës dhe Protokollit lidhur me statusin për Refugjatët, datë 28.07.1951 (Konventa e Gjenevës), e ratifikuar nga Republika e Shqipërisë në 18.08.1992;
2. Direktivës e BE-së mbi standartet minimale për pritjen e aplikuesve për statusin e refugjatit, 2003/09/EC, 27.01.2003 (Direktiva e Pritjes);
3. Propozimit të Ndryshuar për Direktivën e Parlamentit Europian dhe Komisionit Europian duke shtruar standartet për pritjen e azil kërkuesve 01.06.2011 COM2011 320 final, 2008/2044 COD (Direktiva e Pritjes e Ndryshuar);
4. Direktivës 2000/78/EC e 27 Nëntor 2000 (Direktiva e Barazisë së Punësimit);
5. Ligjit për Integrimin dhe Bashkimin familjar të të Huajve që u është Dhënë Azil në Shqipëri, Ligj Nr. 9098 datë 03.07.2003 (Ligji për Integrimin);
6. Ligjit për të Huajt Nr. 9959, datë 17.07.2008 (Ligji për të Huajt);
7. Ligjit për Azilin në Republikën e Shqipërisë Nr. 8432, datë 14.12.1998 (Ligji për Azilin);
8. Ligjit polak për Mbrojtjen e të Huajve, datë 13.06.2003;
9. H. Balla, M. Hereni, Problemet/Risqet e Personave me të cilët kemi të bëjmë, UNHCR Shqipëri, letër e brendshme, Tiranë, 2012;
10. Manual i Praktikave të Mira për integrimin e refugjatëve në Bashkimin Europian, Gjashtë Manuale të Praktikave për Punën, Strehimin, Shëndetsinë, Trainimin, Integrimin Komunitar dhe Kulturor, ECRE, Task Forca për Integrimin, UK, 1997;
11. J. Niessen, T. Huddleston, Manual mbi Integrimin, për hartuesit e politikave dhe praktikuesit, Jan Niessen, Thomas Huddleston of MPG në emër të Komisionit Europian, Drejtoria për Drejtësi, Liria dhe Siguria Edicioni i Tretë, Francë, 2010;

12. *Collantes*, janë migrantë dhe azil-kërkues të cilët kanë të drejtën e kujdesit shëndetsor në BE; Një Vështrim krahasues në 16 vende, Humanetwork, Francë, 2010;
13. *W.Klaus, A.Chrzanowska. Integracja i pomoc społeczna wobec uchodźców w Polsce, Wyniki badań aktowych, Stowarzyszenie Interwencji Prawnej, Warszawa, 2008;*
14. K. Wysieńska, N.Ryabińska, Pashtrehueshmëria e Refugjatëve në Poloni – Rezultatet e një Studimi Pilot, *Instytut Spraw Publicznych, UNHCR Poloni, Varshavë, 2010;*
15. W.Klaus, K.Makaruk, K. Wencel, J. Frelak, Refuzimi për të dhënë ndihmë për tu integruar, *Stowarzyszenie Interwencji Prawnej, Instytut Spraw Publicznych, Varshavë, 2011;*
16. Integrimi i Fëmijëve Refugjatë dhe azil-kërkues në Sistemin Arsimor të Shteteve Anëtare të BE: Vlerësim dhe Promovim i Praktikave më të Mira Aktuale të koordinuara nga Qendra për Studimin e Demokracisë, Sofje, Bullgari, 2012.

2.1 Shërbimet Shqiptare për Refugjatë dhe Migrantë (RMSA)

RMSA është një organizatë jo-qeveritare e ngritur në vitin 2001, nën kujdesin dhe iniciativën e ndertimit të kapaciteteve të UNHCR-së dhe qysh prej themelimit të saj ka qënë partneri kryesor zbatues i UNHCR-së. Antarët e stafit të RMSA-së janë të arsimuar dhe të specializuar me bekgraud social dhe ligjor. Ajo fokusohet në programet për të ardhmen brenda mandatit të saj të ofrimit të shërbimeve sociale dhe ligjore ndaj refugjatëve, azil kërkuesve, migrantëve, Personave të Zhvendosur Brenda dhe grupeve minoritare në Shqipëri.

RMSA, ndërsa punon së bashku me UNHCR-në dhe partnerë të tjerë në mënyrë që të sigurojë që ndihma më esenciale dhe nevojat e mbrojtjes të azil kërkuesve dhe refugjatëve në Shqipëri janë realizuar, njëkohësisht lobon me qeverinë për ta inkurajuar atë për të marrë përgjegjësinë e përgjithshme të refugjatëve, azil kërkuesve dhe migrantëve.

2.2 Projektet dhe aktivitetet e realizuara nga RMSA

1. Ofrimi i Shërbimeve Komunitare për Popullsinë Migrante në Kodër Kamëz, qershor 2002 – qershor 2003;

2. Shërbime Komunitare për Refugjatët dhe Azil Kërkuesit në Shqipëri, tetor – dhjetor 2002;
3. Facilitet për furnizim me ujë në Kodër Kamëz, Lehtësim dhe Përmirësim të kushteve të jetesës të popullsisë migrantë, shtator – tetor 2002;
4. Kujdes dhe Asistencë Mirëmbajtjeje në Shqipëri (Refugjatët dhe Azil kërkuesit), 10 tetor 2002 -17 janar 2003;
5. Program i Kampit Veror – të rinjtë refugjatë dhe migrantë, korrik – gusht 2003;
6. Ofrimi i Shërbimeve Komunitare për Popullsinë Migrante në Kodër Kamëz (faza e dytë), korrik 2003 – korrik 2004;
7. Puna Sociale me Refugjatët dhe Migrantët – Politikat e Migrimit dhe Ligji për Refugjatët, tetor 2004 – janar 2005;
8. Shërbime komunitare për refugjatët dhe azil kërkuesit në Shqipëri, 1 janar -31 dhjetor 2004;
9. Ndërtimi i kapaciteteve efikase të punonjësve socialë mbi mbrojtjen e refugjatëve, 1 shtator - 31 dhjetor 2005;
10. Shërbime komunitare për refugjatët dhe azil kërkuesit në Shqipëri, 1 janar -31 dhjetor 2005;
11. Shërbime komunitare për refugjatët dhe azil kërkuesit në Shqipëri, 1 janar -31 dhjetor 2006;
12. Shërbime sociale dhe ligjore për refugjatët dhe azil kërkuesit në Shqipëri, 2004-2013.

2.3 Shoqata për Ndërhyrje Ligjore (Stowarzyszenie Interwencji Prawnej – SIP)

SIP u themelua në maj të vitit 2005. Ajo është një organizatë “*Watch Dog*”, misioni i të cilës është të përpiqet për respektimin e të drejtave të njeriut dhe kundër trajtimit të pabarabartë. Në mënyrë që të sjellë ndryshim në sistemin ligjor dhe politikave sociale, SIP merr pjesë në konferenca dhe konsultime të akteve ligjore, po ashtu edhe komenton mbi rregullat ligjore, bën hulumtime, kryen monitorime dhe nxjerr opinione eksperte. Ajo gjithashtu edukon dhe jep informacion.

Shoqata është e ndarë në 4 (katër) seksione: Seksioni për të Huajt, Seksioni i Familjes, Seksioni i Rivendosjes së Drejtësisë dhe Seksioni i “Lirisë”. Qysh prej vitit 2005 Seksioni për të Huajt ka ofruar ndihmë ligjore dhe integruese për të huajt, kryesisht për emigrantët e detyruar: azil kërkuesit dhe refugjatët. SIP i përfaqëson ata/ato në procedurat administrative, i ndihmon ata/ato në çështjet zyrtare dhe në të gjitha llojet e çështjeve të integritit, pra gjetjen e punëve, gjetjen e apartamenteve, vendosjen e fëmijëve në shkolla dhe kopshte, etj. SIP gjithashtu ndërhyr kur të drejtat e migrantëve janë shkelur dhe përpiqet të ndryshojë rregullat ose praktikat diskriminuese.

Në shkurt të vitit 2009 SIP filloi një projekt të ri, Qendër Informuese për Migrantët, duke ofruar ndihmë të gjithë migrantëve që qëndronin ligjërisht në Poloni. SIP gjithashtu drejton një Qendër Vullnetarësh. Vullnetarët i shoqërojnë migrantët si përkthyes në të gjitha llojet e situatave, por më shpesh gjatë vizitave të tyre mjekësore.

SIP ndjek nga afër rreth 1500 klientë në vit, një e treta e të cilëve janë migrantë të detyruar.

2.4 Projektet dhe aktivitetet e realizuara nga SIP

1. “Të kuptojmë të tjerët”, Këshillim ligjor anti-diskriminim për migrantët, përfshi trajnimet, mbrojtjen dhe aktive edukimi, 2007;
2. “Qendra Ndërkulturore për Përshtatje Profesionale”, Avokati për përfshirjen e integritit të migrantëve në jetën qytetare, përfshi seminare për zyrtarët e shtetit 2007-2008;
3. “Vlerësim i programeve integruese për refugjatët në Poloni”, Sondazhi i parë për efikasitetin e programeve të integritit për refugjatët në Poloni, 2006-2007;
4. “Avokatët dhe Refugjatët IV”, Ofrimi i konsultimeve ligjore dhe integruese për refugjatët and azil-kërkuesit, 2009-2011;
5. “Fqinjë apo Ndërhyrës – studim mbi diskriminimin e të huajve në Poloni”. Realizimi i disa sondazheve dhe analizave për diskriminimin e migrantëve në Poloni, 2009-2010;

6. "Qendër Informimi për Migrantët". Krijimi i qendrave për shtetasit e vendeve të treta që do t'u ofrojnë atyre – informacion dhe këshillim ligjor, 2009-2011;
7. "Shëndeti për rrjetin e Azil-Kërkuesve dhe Migrantëve të Padokumentuar". Sondazhe dhe analiza të qasjes në kujdesin shëndetsor të UDM dhe AS. Avokati për përmirësimet e nevojshme në këto fusha, 2009-2011;
8. "Fëmijët për Integrimin. Seminare Ndërkulturore". Një numër i konsiderueshëm aktiviteteesh për fëmijë nga një qendër për azil-kërkuesit dhe fqinjët e tyre Polakë, 2011;
9. Bashkëpunimi European Lokal për Integrimin". Përforcim i procesit të dyanshëm të integritit duke u dhënë formë strategjive për integrim të zhvilluara nga institucionet zyrtare dhe organizatat pritëse të emigrantëve, 2011-2012;
10. "Të Ndryshëm por Të Barabartë. Studim mbi trajtimin e barabartë të të huajve në Poloni". Një numër sondazhesh dhe analizash mbi diskriminimin e migrantëve në Poloni, theksi i vënë tek tregu i punës, 2011-2013;
11. "Asistenti Kulturor II". Prezenca e një asistenti kulturor Çeçen në shkollat ku ka fëmijë refugjatë dhe azil-kërkues nga ky rajon – vazhdim i projekteve "Shkollat Multikulturore (tre edicionet)" dhe "Asistenti Kulturor" të filluara në vitet 2008, 2009;
12. "Për të drejtat e Migrantëve të Padokumentuar në Europën Qëndrore". Monitorim i implementimit dhe zbatimit të dispozitave të Direktivës 2009/52/EC (e cila përcakton standardet minimale mbi sanksionet dhe masat që duhen marrë ndaj punë-dhënësve të personave nga vendet e treta që qëndrojnë në mënyrë të paligjshme) në pesë vende të Europës Qëndrore: Poloni, Republika Çeke, Rumani, Sllovaki dhe Hungari, 2012-2014;
13. "Qendra e Informimit të Migrantëve II". Vazhdimësi e qendrës së krijuar për shtetasit e vendeve të treta, ku sigurohen shërbimet ligjore – informacion dhe këshillim ligjor, 2012-2014;
14. "Avokatët për Refugjatët V". Ofrimi i këshillimeve ligjore dhe integruese për refugjatët dhe azil-kërkuesit, 2012-2014.

ME MBËSHTETJEN E:

Stowarzyszenie
Interwencji
Prawnej

